



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI

PROJEKT RREGULLORE
PËR
TË DREJTAT, DETYRIMET, DISIPLINA DHE PËRGJEGJËSITË E NXËNËSVE NË
SHKOLLAT FILLORE TË MESME TË ULËTA NË KOMUNËN E GJILANIT

Gjilan, Shkurt / 2023

Bazuar në nenin 12.2 pika c) e Ligjit për Vetë qeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Nr. 04/ L-032 neni 22, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068 neni 5 shkronja (i) si dhe neni 38 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01 nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe me ndryshimet dhe plotësimet në Statut të komunës 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kuvendi i Komunës, në seancën e mbajtur më : miratoi:

**PROJEKT RREGULLORE
PËR
TË DREJTAT, DETYRIMET, DISIPLINËN DHE PËRGJEGJËSINË E NXËNËSVE NË
SHKOLLAT FILLORE TË MESME TË ULËTA NË KOMUNËN E GJILANIT**

Neni 1

Qëllimi

Rregullorja përcakton dhe rregullon të drejtat, detyrimet, disiplinën, veprimet e ndaluara, përgjegjësinë materiale për dëmin e shkatuar në hapësirat shkollore si dhe e drejta në ankesat e nxënësve të Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta të Komunës së Gjilanit.

Neni 2

Rregullorja është e obligueshme për secilin nxënës. Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejnë dhe zbatohen për sjelljet dhe veprimet e nxënësve qoftë në hapësirat e brendshme të shkollës, hapësirat e jashtme – oborrin e shkollës, jashtë hapësirës së shkollës ku sjellja e nxënësit mund të dëmtoj autoritetin e shkollës, rrezikoj sigurinë e nxënësve dhe të komunitetit si dhe gjatë udhëtimit shkollë – shtëpi dhe anasjelltas.

Neni 3

Drejtori i Shkollës/Menaxhmenti është i obliguar të sigurojë zbatimin e kësaj Rregulloreje si dhe t’i njoftojë të gjithë nxënësit, mësimdhënësit, këshillin drejtues të shkollës, prindërit, komunitetin si dhe çdo person tjetër të interesuar me përmbajtjen e kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Të Drejtat e Nxënësve

1. Të arsimimohet pavarësisht diversitetit në aftësitë psiko-fizike.
2. Të ketë ambient të sigurtë dhe miqësor gjatë qëndrimit në shkollë dhe aktivitete jashtëshkollore.
3. Përmes kërkesës me shkrim nga prindi të lirohet nga ora mësimore vetëm atëherë kur është në dobi të tij/saj.
4. Të shfrytëzojë hapësirat shkollore si brenda ashtu edhe jashtë.
5. Të përdor mjete të ndryshme shkollore.
6. Të frekuentoj bibliotekën e shkollës në pajtim me rregullat dhe orarin e punës së bibliotekës.

7. Të zhvilloj talentin dhe prirjen në lëndët e ndryshme mësimore.
8. Të marrë pjesë në aktivitete të lira të nxënësve ;
9. Të shpërblehet moralisht dhe materialisht, të avancohet në bazë të suksesit të dëshmuar në fusha të ndryshme të kurrikulës dhe aktivitete të lira në përputhje me Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.
10. T'i vlerësohet dhe respektohet dinjiteti duke qenë i mbrojtur nga çdo formë përbuzje, bullizmi, poshtrimi, dhune dhe keqtrajtimi fizik dhe psikik.
11. Të informohet nga mësimdhënësi për notën që merr duke i përfshirë të gjitha instrumentet vlerësimit në veçanti.
12. Të marrë dokumente si dëshmi për kryerjen e klasës, nivelit, transferimit dhe gjitha dokumentet tjera që janë në kompetencë të shkollës.

Neni 5 Detyrimet e Nxënësve

1. Nxënësi duhet të vijë në shkollë 10 minuta para fillimit të mësimit;
2. Nxënësi është i detyruar të jetë i përgatitur me tekste, fletore dhe të gjitha mjetet e punës për orën e mësimit, t'i kryej detyrat e shtëpisë me rregull, të jetë i disiplinuar, të kujdeset për pastërtinë personale, për pastërtinë e klasës dhe të shkollës.
3. Nxënësi duhet ta bartë me vete uniformën dhe kartelën identifikuese.
4. Mungesat e nxënësve nuk arsyetohen në asnjë rast përveç atyre që kanë dëshmi vërtetimin mjekësor dhe në raste të rralla kur ka një arsyetim paraprak nga prindi që merret në konsideratë nga kujdestari i klasës.
5. Nxënësi gjatë kohës së orarit mësimor nuk ka të drejtë të dalë jashtë hapësirës shkollore me përjashtim të rasteve të veçanta me kërkesë të prindit apo kujdestarit të tij.
6. Nxënësi, që është pjesëmarrës në aktivitete shkollore jashtë shkollës nuk merr mungesa.
7. Nxënësit nuk i lejohet të dalë nga ora mësimore për asnjë arsye vetëm nëse i paraqitet ndonjë shqetësim shëndetsor . Në rast të tillë mësimdhënësi i lëndës ose kujdestari i klasës e thërret në telefon prindin e nxënësit.
9. **Nxënësi i cili gjatë vitit shkollor mungon 15 orë pa arsye i shqiptohet masa disiplinore thyerje e notës së sjelljes në sjellje e mire (3);**
10. **Nxënësi, i cili mungon pa arsye 25 orë mësimore i shqiptohet masa disiplinore Thyerje e notës së sjelljes në Sjellje jo e mirë(1)**
11. Nxënësi gjatë pushimit të shkurtër duhet të qëndrojë në klasë.
12. Nxënësit që kanë mësim në kabinete duhet të shkojnë gjatë pushimit e jo pasi të mbarojë pushimi.
13. Nxënësit kujdestarë të klasës kujdesen për ajrosjen e klasës dhe pastrimin e tabelës gjatë pushimit të shkurtër.
14. Nxënësi është i obliguar të kujdeset për gjërat e veta personale, shkolla nuk është përgjegjëse për humbjen dhe dëmtimin e gjërave derisa nxënësi është në shkollë.
15. Nxënësi duhet të kujdeset për pastërtinë dhe ruajtjen e objekteve brenda klasës dhe brenda shkollës.

Neni 6
Veprimet e Ndaluar

1. Të pengojë zhvillimin e procesit mësimor për asnjë arsye, në rast të çfarëdo lloj parregullsie, fyerje, bullizmi apo nënqimimi nga ana e mësimdhënësit, nxënësi obligohet ta njoftoj me shkrim drejtorin e shkollës.
 2. Të prishë rendin dhe disiplinën në shkollës dhe gjatë orës së mësimimit (të bëjë zhurmë apo forma të tjera të pengesës për të tjerët),
 3. Përdorimi i telefonave celularë në pajtim me Udhëzuesin e MASHT-it, Nr. 20/18;
 4. Të vishet me veshje ekstravagante: pantollona të grisura, bluza të shkurtëra që zbulohet beli, mini funde, pantollona të shkurtëra mbi gjunjë etj të cilat ekspozojnë pjesë të trupit.
 5. Të mbajë thonjë të zgjatur, të ngjyrosur, makiazh, të vendos vath të mëdhenj, të vendos vath në pjesë të ndryshme të trupit përveç në vesh, të vendos tatuazhe etj.
 6. Të përtyp çamçakëz gjatë ores mësimore.
 7. T'i ofendojë shokët, shoqet, mësimdhënësit dhe gjithë stafin tjetër të shkollës.
 8. Të kopjojë në klasë gjatë kryerjes së detyrave me shkrim,
 9. Të bisedojë me zë të lartë në mjediset e shkollës, të lëvizë pa nevojë në pjesën e dedikuar për arsimtarë dhe në aneksin e administratës së shkollës si dhe të hyjë në sallën e arsimtarëve pa prezencën e kujdestarit të klasës, të arsimtarit kujdestar të ditës ose pa lejen e drejtorit të shkollës,
 10. Të përdor, mbajë apo shes pije alkoolike, cigare elektronike dhe substanca narkotike, armë të ftohta apo të nxehta ose gjësende të rrezikshme për jetën e nxënësve dhe personelit tjetër në shkollë. Udhëheqësia e shkollës rezervon të drejtën të kontrollojë çantat e nxënësve pa paralajmërim.
 11. Të dëmtojë inventarin e shkollës, bazën materiale teknike dhe didaktike të shkollës,
 12. Të sjellë persona të huaj (të panjohur) në shkollë, pa paralajmërim në drejtorinë e shkollës,
 13. Të përvetësojë në mënyrë të palejuar gjësendet e huaja,
 14. Të falsifikojë të dhënat në dokumentet pedagogjike-shkollore (ditar, libër amzë, dëftesë, diplomë etj.),
- Për disa veprime të ndaluara sipas kësaj Rregulloreje, Drejtori i shkollës lajmëron edhe Shërbimin Policor të Kosovës
- Ndalesa të tjera të caktuara nga drejtori i shkollës.

Neni 7
Masat Disiplinore të Shqiptuar për Nxënësit

1. Në rast se nxënësi bie ndesh me pikat 1 deri 9 të nenit 6 të kësaj Rregulloreje, nxënësit i shqiptohet :
 - 1.1 Vërejtje me gojë,
 - 1.2 Vërejtje me shkrim dhe thyerje e notës së sjelljes,
 - 1.3 Pezullim i përkoshëm nga garat, eskursionit, vizitat, shetitjet etj.

2. Në rast se nxënësi bie ndesh me pikat 10-14 të nenit 6 të kësaj Rregulloreje, nxënësit i shqiptohet:
 - 2.1 Ndërrimi i përkoshëm i klasës brenda shkollës;
 - 2.2 Ndërrimi i përkoshëm të shkollës për një vit.

Neni 8

Qëllimi i Masave Disiplinore ndaj Nxënësve

1. Shqiptimi i masave disiplinore për nxënësit ka për qëllim:
 - 1.1 T'i korrigjojë sjelljet e patolerueshme që dëmtojnë dhe pengojnë nxënësit e tjerë, cenojnë personalitetin e tyre, të mësimeve dhe rendin e përgjithshëm në shkollë,
 - 1.2 Të krijojë klimë të volitshme mësimi e pune në shkollë dhe jashtë saj,
 - 1.3 Mbrojtjen e ambientit dhe pasurisë së shkollës;
 - 1.4 Të mësohen në shkollë të zbatojnë ligjshmërinë,
 - 1.5 Të respektohen normat e garantuara me konventat ndërkombëtare,
2. Shqiptimi i masave nuk guxon të jetë i motivuar e as rrjedhë e:
 - 2.1 Hakmarrjes,
 - 2.2 Frikësimit,
 - 2.3 Nënçmimit,
 - 2.4 Cenimit të personalitetit apo dinjitetit të nxënësit,
 - 2.5 Asnjë motiv tjetër të kësaj natyre.

Neni 9

Komisioni Disiplinor

1. Çdo shkollë ka për detyrë të themeloj komisionin disiplinor brenda shkollës;
2. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë, tre (3) nga mësimeve, dy (2) nga radhët e prindërëve;
 - 2.1 Shkollat të cilat kanë më pak se 250 nxënës, komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë sipas përbërjes ngjashëm sipas paragrafit 2 të kësaj Rregulloreje.
3. Anëtarët nga radhët e mësimeve i propozon Këshilli i Mësimeve në nivel Shkolle;
4. Anëtarët nga radhët e prindërve i propozon Këshilli i Prindërve në nivel shkolle;
5. Vendimin për emërimin e nxjerr, Drejtori i IEAA-së;
6. Mandati i komisionit është dy (2) vjeçar.

Neni 10

Përgjegjësia për Shkaktimin e Dëmit Material/Inventarit të Shkollës

1. Dëm konsiderohet : dëmtimi i inventarit brenda dhe jashtë Shkollës – oborrin e Shkollës, thyerje, shkarravitje në banka, karrige, mur, bankës, dritares, derës, dritave, tabelës, projektorit, nyjeve sanitare, pajisjet sportive etj.,si dhe dëmtimi i ambientit ekologjik.
2. Nxënësi, i cili me qëllim ose nga pakujdesia e tepruar i ka shkaktuar dëm material shkollës, është i obliguar që të njëjtin ta kompensojë.

3. Në qoftë se dëmit material e kanë shkaktuar më shumë nxënës, atëherë ata janë të obliguar ta kompensojnë, secili për pjesën e fajit të vet.
4. Në qoftë se nuk mund të zbulohet fajtori i shkaktimit të dëmit material, atëherë të gjithë nxënësit e klasës janë të obliguar të bëjnë kompensimin e dëmit të shkaktuar proporcionalisht.
5. Kompensimin e dëmit është i obliguar ta bëjë prindi i nxënësit apo kujdestari ligjor i tij.
6. Për qdo veprim lidhur me shkaktimin e dëmit material apo veprimet e ndaluara sipas nenit 6 të kësaj Rregulloreje nga ana e nxënësit, duhet të njoftohet prindi i tij.

Neni 11

Vlerësimi i Dëmit, Shqiptimi i Masës dhe Komisioni

1. Vlerësimin e dëmit material dhe shqiptimin e masës për kompensim e bënë komisioni i përbërë prej tre (3) anëtarëve të cilin komision e emëron Drejtori i Shkollës.
2. Për shqiptimin e masës për kompensimin e dëmit material, komisioni kompetent është i obliguar të mbajë procesverbal, të përpilojë raport dhe të lëshojë vendim me shkrim;
3. Procesverbali, raporti si dhe vendimi për kompensimin e dëmit i dorëzohet Drejtorit të Shkollës i cili njëherit kujdeset edhe për ekzekutimin e masës së përshkruar në vendim.
4. Dëmi i shkaktuar vlerësohet dhe mund të kompensohet me zëvendësimin me sendin e njejt, riparim të sendit apo në të holla.

Neni 12

E Drejta e Nxënësit për Ankesë

1. Kundër vendimit për kompensimin e dëmit material apo masës disiplinore të shqiptuar sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje, nxënësi apo prindi i tij ka të drejtën të paraqesë ankesë me shkrim.
2. Ankesa në shkallë të parë i paraqitet Këshillit Drejtues të Shkollës, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimi i vendimit. Këshilli Drejtues e shqyrton dhe vendos ankesën në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.
3. Kundër vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës, mund të paraqitet ankesë në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimi i vendimit komisionit të DKA-së. DKA-ja e shqyrton dhe vendos ankesën në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.
4. Me restin e paraqitjes së ankesës në shkallë të parë apo të dytë, pezullohet përkohësisht masa disiplinore deri në vendimin përfundimtar;
5. Nëse nxënësi/prindi i nxënësit nuk e zbaton vendimin për kompensimin e dëmit material, atëherë lënda përmes Sekretarit të Shkollës procedohet në Gjykatën Kompetente.

Neni 13

Çdo dispozitë e kësaj Rregulloreje që është në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të udhëzimeve përkatëse administrative në fuqi, do të vlejnjë dispozitat e ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.

Neni 14

Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullores

Kjo rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë nga Kuvendi i Komunës në përputhje me nevojat ligjore dhe organizative.

Neni 15

Përgjegjësia dhe Zbatimi i kësaj Rregullore

1. Përgjegjës për kujdesin në zbatimin e kësaj rregullore është Menaxhemti i Shkollës.
2. Mos zbatimi i kësaj Rregulloreje, pasojnë masat disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi Komunal.

Gjilan, më

Kryesuesi i KK

/Ariantit Sadiku/